



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA IV

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 92.
Prishtinë, më 25.03.2014 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302**

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Hatim Baxhaku, Saša Milosavljević, Jelena Bontic, Petar Miletić, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Mungoi: Elmi Reçica dhe Glauk Konjufca.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuese e OSB-së, Lejla Selimi, përfaqësuese e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues nga ECMI- Lura Pollozhani, Trim Kabashi, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilyas.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković** –kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**

Të ftuar.

- **Kryetari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Fikrim Damka**
- **Ministri i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Nenad Rašić.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja– konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;

Kryesuesja- në fjalën e saj tha se komisioni ka paqartësi në Raport amandamente të Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti. Në këtë takim Komisioni ka ftuar kryetarin e komisionit funksional Fikrim Damka dhe Ministrin MPMS Nenad Rašić për të marrë sqarime lidhur me amendamentin 19. Ajo lexoi amendamentin 19 nën 22. pika 1,1 dhe 1,2, me tekstin si në vijim :

1,1 Në rast të vdekjes së pensionistit, pagesa e pensionit ndërpritet në muajin pasues pas vdekjes së tij/saj;

1.2. Në rast se përfituesi i pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar, fiton nënshetësinë e shtetit, me të cilin Republika e Kosovës, nuk ka Marrëveshje Bilaterale për sigurime sociale;

Duke pasur parasysh të drejtën pensionale të moshës në Kosovë, edhe komuniteti serb e ka të drejtën e shtetësisë së dyfishtë, pra të Kosovës dhe Serbisë.

Pyetja e saj ishte, nëse këta persona nuk janë banorë të Kosovës, me këtë rast i humbet e drejta e pensionit themelor të pleqërisë apo kjo çështje mundet të zgjidhet në një formë tjetër. Fillimisht, për këtë pikë fillimisht fjalën ia dha kryetarit të komisionit për mirëqenie sociale.

Fikrim Damka – kryetar i komisionit funksional, me theks të veçantë tha se Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti ka ardhur nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Me këtë ndryshim të nenit 22, pika 1,2, përshkruhet se pagesat e pensionit bazik të moshës 65 vjeçare do të ndërpriten në rastet kur pensionisti vendoset për banim të përhershëm në një shtet tjetër. Lidhur me këtë çështje dha sqarim se nëse një person i ka dy shtetësitë dhe nuk është rezident p.sh. jeton në Tiranë, Zvicër, Turqi etj, atëherë ai automatikisht e humb pensionin themelor të moshës, në Kosovë.

Nenad Rasic - theksoi se ndryshimi i nenit është bërë në bazë të faktit, nëse një pensionist merr pension në shtetin e Zvicrës dhe njëherit të shtetit të Kosovës, në këto raste shteti i Zvicrës ndjehet i dëmtuar dhe ka pasur vërejtje që ne ti bëjmë kompensimet.

Është shumë me rëndësi ajo që diskutoi kryetari i komisionit funksional, secili person që ka nënshetësinë ndërsa është i regjistruar si banor në një lokacion tjetër, në bazë të Ligjit e humb të drejtën e pensionit themelor të pleqërisë.

Ai shtoi se pa marrë parasysh amendamentin e komisionit funksional, bazuar në dokumentacionin e ministrisë tonë, personat të cilët i plotësojnë kriteret e moshës 65 vjeçare dhe janë në listën e deritanishme, vazhdojnë të marrin pensionet në vlerë prej 65 euro.

Minire Begaj – përveç çështjeve që u diskutuan nga parafolësit ajo shtoi se me nenin 1- qëllimi, pika 1.3 të Ligjit, rregullohet krijimi i një strukturë unifikuese të standardizuar për shtetasit Kosovarë dhe shtetasit e huaj që kanë marrëveshje Bilaterale mes shteteve për sigurime sociale, të cilat i nënshkruan Republika e Kosovës.

Pikërisht Ministria për PMS, zhvillon politika që me këtë ligj të harmonizohet çështja kur duhet të ndërpritet pensioni bazik dhe pensioni me aftësi të kufizuar.

Sa i përket statuseve të refugjatëve, azil kërkuesve apo ndonjë formë plotësuese tjetër, me këtë Ligj nuk diskriminohen këto tri kategorive, por duhet të plotësohet standardi që të jetë rezident në Republikën e Kosovës.

Petar Miletic – nuk ishte i pajtimit të merren shembujt e shteteve tjera nga se këtu bëhet fjalë për sigurimin e pensioneve për 95% të komunitetit serb, njëjtë duhet vepruar edhe për komunitetin turk, boshnjak, goran , romë etj

Theksoi se komuniteti jonë është i shqetësuar se me Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, mund të ndërpriten pensionet për qytetarët serbë të cilët kanë kontribuar në Kosovë andaj meriton edhe ky komunitet të gëzojë të njëjtat benificione. Është e kuptueshme se interesi i Kosovës është të mbrohet buxheti, njëkohësisht të mos ndahen dy pensione, ai i shtetit të Kosovës dhe qytetarëve të cilët nuk kanë vendqëndrimin të përhershëm. Mendon se kjo çështje paraqet tendencë, nga se nuk është në harmoni me të gjitha standardet.

Ai theksoi se me këtë propozim amendament vijmë në situatë specifike siç është rasti i personave të komunitetit serbë, boshnjakët, goranë etj, të cilët kanë statusin e refugjatit ku të njëjtit nuk kanë mundësi të lajmërohen çdo 6 muaj. Jemi në dijeni se ende nuk është hapur konsullata në Beograd dhe nuk është arritur marrëveshja Bilaterale Kosovë - Serbi. Ishte i interesuar të dijë si do të procedohet çështja e pensionit themelor, për këta qytetarë .

Nenad Rasic – Mund të them se kjo çështje nuk është tendencioze nga se me Ligj interpretohet se secili person pa marr parasysh a ka punuar apo jo dhe të cilët kanë mbushur moshën 65 vjeçare, fitojnë të drejtën në pension bazik të moshës dhe të njëjtit çdo 6 muaj duhet të paraqiten në qendër sociale. Kjo vlen si për shqiptarët ashtu edhe për komunitetet tjera të cilët jetojnë në Kosovë. Në bazë të Ligjit, amendamenti i komisioni funksional është i arsyeshëm, sepse rregullohet pozita e personit i cili është rezident, ka letërnjoftim të Kosovës dhe është në përputhje me marrëveshjen Bilaterale me Kosovën.

Fikrim Damka- Ai tha se në këtë Ligj, Komisioni funksional nuk ka bërë ndryshime shtesë në versionin e Ministrisë, kemi modifikuar nenin 22, pika 1,2, në rastin kur një person fiton nënshtetësinë e shtetit në të cilën Republika e Kosovës nuk ka marrëveshje Bilaterale të sigurimeve sociale.

Sasa Milosavljevic- në bazë të diskutimit u tha se personi i cili e ka nënshtetësin e Kosovës dhe i mbush 65 vjet gëzon të drejtën në marrjen e pensionit të moshës, andaj pyetja e tij ishte pse është përcaktur me Ligj si kusht të jetë marrëveshja Bilaterale, pasi komuniteti serb i cili nuk është rezident automatikisht e humb të drejtën e marrjes së pensionit bazik.

Mursel Halili – sipas Ligjeve të miratuara të Kosovës, reezident janë të gjithë personat të cilët kanë letërnjoftimin e Kosovës . Ishte i interesuar të dijë si do të rregullohet me këtë Ligj, pozita e personave që janë me vendbanimin në Nish, Zagreb apo në ndonjë vend tjetër dhe të cilët llogariten si persona të shpërngulur apo e kanë statusin e azilantit .

Hatim Baxhaku- me këtë nen të komisionit funksional, nuk humbet e drejta e dy nënshtetësisë dhe kjo çështje nuk prek komunitetet për periudhën që jetojnë jashtë Kosovës. Ishte i mendimit që amandamenti të plotësohet me fjalinë ‘personi të ketë nënshtetësinë e shtetit tjetër’ .

Kryesuesja – tha se me këtë nen kemi paqartësi për humbjen e të drejtës së pensionit bazik të moshës, siç është rasti i personave të cilët kanë kontribuar 15 vite në Kosovë. Kërkesa e saj ishte të ndryshohen kriteret procedurale dhe administrative të përcaktuara me këtë Ligj , pa qen të bazuara në marrëveshje Bilaterale.

Ajo propozoi që Ministria PMS, me ndonjë akt administrativ të rregullohet krijimi i një kornize ligjore të unifikuar për sigurimin e vazhdueshëm të pensioneve për shtetasit të cilët nuk janë rezident në Kosovë.

Fikrim Damka - me këtë nen rregullohen procedurat e verifikimit të keqpërdorimeve për pagesa të pensioneve themelore nga se pensionistët duhen të lajmërohen çdo 6 muaj në qendër sociale. Prandaj, personat të cilët janë refugjatë në Serbi apo në ndonjë vend tjetër e të cilët nuk gëzojnë statusin të jenë rezident në Kosovë, me këtë rast i ndërprehet pensioni bazik i moshës dhe i aftësisë së kufizuar, të përcaktuara me këtë Ligj.

Minire Begaj - theksoi se kriteret e Ligjit janë të përcaktuara me Udhëzim administrative, i cili me datën 31.12.2013 është nënshkruar nga Ministri, me të cilin rregullohet pozita e personave të cilët janë rezident dhe njëherit e fitojnë shtetësinë

Me dispozitë të standardizuar, pensionisti i cili jeton jashtë Kosovës duhet të lajmërohet çdo 6 muaj në MPMS. Nëse nuk lajmërohet dy herë brenda vitit, në këto raste kërkohet verifikimi i vendbanimit. në të kundërtën automatikisht i ndërpritet pensioni bazik.

Të njëjtin Udhëzim Administrativ do e përcjellim te stafi mbështetës, që Komisioni ta ketë si dëshmi.

Nenad Basic – në fjalën e tij tha se gjendja faktike është se Ministria nuk ka kompetencë as bazë ligjore të konstatojë metodologjinë që kishte qen ideale për të paguar pensionet personave të cilët janë të shpërngulur, pasi me Ligj është përcaktuar se pensioni themelor ju ndahen personave të cilët janë rezident dhe është arritur marrëveshja Bilaterale.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković